

PORTRETE TË DALLUARISH NË DIASPORË: SKENDER NIKOLIQI
DREJTUES I QENDRËS PËR ARSIMIM DHE KËSHILLIM NË BAZEL

Veprimtari mësimore edukuese, kulturore dhe humaniste

Zvicra është një shtet që të ofron mundësi për integrimin, sidomos nëse njeriu ka shkathtësinë që të dijë t'i përvetësojë ato që t'i ofron ky shtet. Ka qenë obligimi ynë qytetar dhe kombëtar që bashkëatdhetarëve tu gjendemi pranë, nëse jo si individ, atëherë si shoqëri apo asociacion. Ishte pra kjo Qendër një urë lidhëse për të çuar përpara kërkesat dhe nevojat e shqiptarëve në këtë shtet

Të bëjmë diç më shumë për atdheun Skender Nikoliqi, nga Gjakova, u nis në Zvicër një ditë gati spontanisht me ftesën e një familje zvicerane. Në vitin 1988, djaloshi i ri nuk e kishte menduar se do të mbetej përgjithmonë atje. Është nisur për një kohë të shkurtër, dhe gjatë atij pushimi nisi të punojë në sektorin për kursimin e energjisë (parallogari dhe llogari për ngrohjen qendrore), profesion të cilin e ushtron edhe sot. Edhe për Skenderin vijonin ditët, vitet, ashtu gati të pandryshuara

si për çdo mërgimtar. Por dëshira e kahmotshme që me devotshmëri të bënte diçka edhe për bashkëkombësit e vet e shtyri që që krahas punës në profesionin e tij, të bëj diçka më shumë. Fillimisht, në qytetin e Bazelit e hapën Këshillimoren shqiptare e cila më vonë u shëndrrua në Qendër për Arsimim dhe Këshillim të emigrantëve. Ishte viti 1997, dhe një pjesë e rinisë dhe e të rriturve të ardhur që nga vitet nëntëdhjetë ishin në një pozitë të palakmueshme dhe pa ndonjë perspektivë të qartë për të ardhmen. Duke i vështruar këto dukuri kishte lindur ideja që të ndërtohet një ekip punues i cili do të krijonte partneritet me institucionet zvicerane dhe bashkërisht të punonin për zgjidhjen e problemeve që kishin bashkëatdhetarët tanë. Me një punë të përkushtuar, Qendra e vazhdon punën edhe sot e kësaj dite duke arritur që gjatë një viti në këtë asociacion, kurset intensive t'i ndjekin rreth 200 vetë, kështu që deri më tash, me certifikata janë pajisur rreth 1000 vetë. Fillimisht, kurset i kanë ndjekur vetëm shqiptarët me banim në Zvicër, ndërsa në dy vitet e fundit këto kurse ndiqen edhe nga të huajt me prejardhje të ndryshme si nga (Afrika, Azia, ish Republikat Sovjetike, nga Ballkani, e nga vende të tjera), pjesa më e madhe e të cilëve kanë qenë azilkerkues, vendet e të cilëve janë me probleme ekonomike dhe politike.

Përveç kurseve, në këtë Qendër janë zhvilluar edhe këshillime për zgjedhjen e profesionit prej të cilave kanë përfituar në përgjithësi rreth 9000 vetë në forma të



Skender Nikoliqi drejtues i Qendrës për Arsimim dhe Këshillim në Bazel

ndryshme qoftë duke ndjekur kurse, qoftë duke marrë informacionet përkatëse për tu aftësuar në lëmitë përkatëse apo edhe duke u pajisur me këshilla praktike në fusha të ndryshme sociale për të mundësuar përshtatjen me të lehtë në kushtet dhe rrethanat e jetës zvicerane.

Zvicra është një shtet që të ofron mundësi për integrimin

Teksa vizitojmë lokalet e pastra dhe të rregulluara me shije të kësaj Qendre, shfletojmë certifikatat e vijuesve të kurseve, shfletojmë artikujt e shumtë që janë bërë për këtë asociacion, kundrojmë me pasion pikturat origjinale me motive shqiptare në mur dhe bibliotekën me libra në gjuhë të ndryshme. Duke parë tërë këtë

ambient dhe punën që është bërë nuk kemi pse të mos e potencojmë se kjo Qendër, padyshim, është një urë lidhëse në mes të shqiptarëve dhe zviceranëve, kryesisht të institucioneve zvicerane. Për këtë vet Skender Nikoliqi, thotë: "Ne si qendër, duke e parë nevojën që komuniteti shqiptar ka pasur vështirësi për integrim në shoqërinë zvicerane në njërin anë dhe duke qenë të vetëdijshëm për pamundësinë e institucioneve tona në Kosovë për të bërë diç në këtë drejtim në anën tjetër, atëherë u pa e nevojshme dhe si një domosdoshmëri e kohës që të hapet një qendër e nivelit të tillë në të cilën përpos këshillimeve konkrete, do të ofroheshin edhe kurse të lëmive të ndryshme. Nisi me: kurse për gjuhën gjermane, informatikë, ndërtimtari, elektrikë, energji solare,

-Në shtator të vitit 2000 është hapur një zyre koordinatore e Qendrës për Arsimim dhe Këshillim, e cila ka bashkëpunuar me shkollat e mesme profesionale në Kosovë (Gjakovë, Pejë) ku është bërë në fillim përrurimi i më se 9 kabineteve/ punishteve/ klasa mësimi për mbajtjen e kurseve profesionale si (informatikë, elektrikë, administrative, të gjuhës angleze, energji solare, mekanik, për përpunimin e metaleve, etj). ku gjatë një viti kanë ndjekur kurset intensive në këto lëmi nga 600-700 individë.

"Gjithashtu kemi bërë edhe trajnimin e mësimeve të disa shkollave të mesme dhe fillore, ku trajnimin e tyre e kanë bërë ekspertë të kësaj lëmie nga Zvicra".



Promovim i librave të Pjetër Arbnorit dhe Esat Stavilevcit

shëndetësi, për tu përqëndruar më pas kryesisht në lëmin e mësimin të gjuhës gjermane. Informatikës si dhe funksionimi i sistemit në mjediset e shoqërisë zvicrane. Duke qenë edhe vet dikur një emigrant i ballafaquar me këto probleme, Skender Nikoliqi iu përkushtua pikërisht këtyre hapave nëpër të cilat ka ecur vet para 16 vjetësh. "Zvicra është një shtet që të ofron mundësi për integrimin, sidomos nëse njeriu ka shkathtësinë që të dijë t'i përvetësojë ato që t'i ofron ky shtet. Ka qenë obligimi ynë qytetar dhe kombëtar që bashkëatdhetarëve tanë tu gjendemi pranë, nëse jo si individ, atëherë si shoqëri apo asociacion. Ishte pra kjo Qendër një urë lidhëse për të çuar përpara kërkesat dhe nevojat e shqiptarëve në këtë shtet".

Veprimtari të gjithëmbarshme sportive e kulturore

Pjesë përbërse e punës së kësaj qendre janë veprimtaria sociale, kulturore dhe sportive ku ekipi i kësaj qendre ishte përqëndruar me të gjitha resurset dhe me tërë seriozitetin për të ndihmuar ata të cilët kishin nevojë e në veçanti

bashkëatdhetarët tanë. Si rezultat i tërë kësaj, organet kantonale duke çmuar punën e palodhshme dhe të çmueshme për integrim inicuan "Çmimin për integrim" dhe për herë të parë në vitin 1999 ky çmim i jepet ekipit të kësaj qendre për punën më të sukseshme në lëminë e integrimin nga të gjitha grupet e të huajve. Ky ishte edhe një motivacion dhe një shtytje e re për të dhënë kontributin maksimal në mënyrë edhe më të përkushtuar që të lehtësojmë bashkëjetesën në shoqërinë zvicrane. Kur bëhet fjalë për sportin, është ndihmuar klubi i futbollistik shqiptar "Dardania" në Bazel, i cili tashmë luan në ligën e tretë zvicrane dhe ka dy ekiye. Në veprimtaritë kulturore, është dhënë një kontribut vlerësues, gjë që është vënë në spikamë sidomos në vitet e fundit duke marrë parasysh edhe organizimin e "Dita e kulturës shqiptare në Zvicër" e cila ka përmbajtur muzikë klasike shqiptare, paraqitje të kostumeve kombëtare, ekspozitë të fotografive, mbrëmje e folklorit shqiptar, muzikë e lehtë dhe film dokumentar e sidomos në këtë kontekst vlen të veçohet mbrëmja me këngëtarët Nexhmije Pagarusha dhe Vaçe Zela. Janë organizuar me përkujdesjen

-Bujaria shqiptare ka qenë dhe është që të ndajë të mirën me të tjerët ndaj edhe pashmangshëm puna e kësaj qendre ka qenë në këtë vazhdë. Nëpër dyert e këtij asociacioni kanë dalur të aftësuar edhe vijues që u kanë takuar popujve të vendeve të ndryshme të cilët kanë pasur vështirësi për tu integruar në shoqërinë zvicrane.



Moment me rastin e ceremonisë së ndarjes së diplomave në Basel



Mbrëmje kulturore me Pjetër Arbnorin, Esat Stavilevcit dhe Pajazit Nushin

e kësaj Qendre po ashtu edhe mbrëmje artistike, orë letrare dhe promovime veprash të poetëve, artistëve e shkrimtarëve të njohur shqiptar si Azem Shkreli, Ali Podrimja, Pjetër Arbnori, Esat Stavilevcit, Jusuf Buxhovi, Shyqyri Nimanit, Fatmir Krypa, Nazmi Rrahmani, Sali Bashota, Daut Demaku, Agim Gjakova etj. Në këtë vazhdë në prag të Beatifikimit të Nënë Terezës, në tetor të vitit të kaluar është botuar nga kjo Qendër edhe libri me poezi i Nënë Terezës në tri gjuhë; shqipe, gjermane dhe angleze "Mësomë të dua Lehre mich zu lieben Teach me to Love" pastaj është ndihmuar botimi i librit monografi për Vaçe Zelën. etj. Në kuadër të afirmimit të vlerave të mirëfillta kulturore nuk janë lënë anash edhe talentët e rinj të cilët jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, duke i motivuar ata përmes ndihmës morale dhe materiale

për krijimet e tyre letrare apo edhe grupe të ndryshme muzikore për të dëshmuar talentin e tyre edhe para publikut vendës.

Qendër ku mësojnë paralelisht nënat dhe fëmijët

Sipas fjalëve të Nikoliqit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, në fillim është dashur të punohet shumë për të motivuar dhe sensibilizuar shqiptarët për këto kurse dhe për të bërë që të kuptohet vlera e tyre dhe domosdoshmëria për ngritjen profesionale. Nëse në fillim ka pasur vështirësi në këtë plan, tash ekzistojnë listat e pritjes për të marrë pjesë në kurset që ua ofron qendra. Është shumë me rëndësi që gjysma janë gra e sidomos nëna të cilat punojnë me fëmijët e tyre. Dhe derisa bisedonim në këshillimore, shihnim se në njërën



Promovimi i Antologjisë „Eni vjen prej Çamërie“, Ali Podrimja, Basel



Kemal Shajri, sekretar dhe përgjegjës i projekteve për integrimin e të rinjëve



Ceremonia e ndarjes së çmimit për integrim stafit të ABSM-it.



Dite e kulturës shqiptare, e pranishme artistja e madhe e këngës Vaçe Zela



Seminar me profesor Daut Demaku në lokalet e qendrës për arsim (ABSM)

institucionet vendore konsiderohet si një asociacion serioz që po lidh urë miqësie shqiptaro – zvicerane ku çdo ditë përmes formave konkrete po avanson, duke zhdukur keqkuptimet dhe paragjykimet që ekzistojnë për të krijuar kështu një imazh tjetër në përgjithsi për komunitetin tonë.

Shoqëria dhe shteti zviceran ndihmojnë bashkëatdhetarët tanë

Stafi i kësaj Qendre përbëhet nga rreth njëzet bashkëpunorë të profileve të ndryshme: mësimdhënës, pedagog, psikologe, inxhinjer, mjek, punëtorë social, në mesin e të cilëve ka edhe doktorë shkencash, etj. Në Qendër, punohet çdo ditë në të gjitha drejtimet sipas orarit zyrtar e varësisht nga kërkesat, punohet edhe jashtë orarit zyrtar.

Kemajl Shaqiri, mediator në këtë qendër si bashkëpunorë që nga themelimi aktualisht udhëheq projektet për azilkerkues si dhe merr pjesë aktive në udhëheqjen e projekteve integruese për të rinjtë. “Është kënaqësi e veçantë të ndihmohen bashkëatdhetarët tanë duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat ndeshen ata. Qendra jonë është e pajisur me infrastrukturë të standardeve moderne ku nuk mungon as përkujdesja profesionale dhe motivimi sepse për tu punësuar në shoqërinë zvicerane, janë të domosdoshme si njohja e gjuhës ashtu edhe ngritja profesionale. Në mbarim të kurseve që zgjasin nga 3 12 muaj, shihet se rezultati është jashtëzakonisht i mirë dhe se pjesmarrsit punojnë me zell dhe mundohen që me çdo kusht të nxënë të gjitha dijet që ua ofron qendra jonë dhe të ecin në hap me kohën. Krahas kesaj edhe ne ndihemi krenar dhe të motivuar për të vazhduar punën më me ngulm dhe me një intensitet më të shtuar”.

Në fillim, e gjithë puna e stafit të kësaj Qendre është bërë në mënyrë vullnetare, por më pas, që nga fundi i vitit 1998, kanë kontribuar dhe kanë ndihmuar edhe institucionet zvicerane, duke nisur nga fondacioni CMS, institucionet lokale-kantonale, e kryesisht ato federale zvicerane dhe ka pasur ndihmë edhe nga individë të



Mbrëmje kulturore me bilbilat e këngës shqipe, Vaçe Zelën, Nexhmije Pagarushën dhe me poetin Ali Podrimja në Basel



Seminar për energji solare

anë nënat mësonin për gjërat që iu nevoiteshin në gjuhën gjermane si dhe për jetë, kurse në anën tjetër të objektit, fëmijët e moshave të luanin të mbikqyruar nga një kujdestareje ditore. Një nënë e re me emrin Luljeta tregonte se si më parë, për të punuar me mësimin e fëmijëve të saj është dashur ta pres burrin të vijë nga puna, kurse tash me mësimin që ka bërë në këtë qendër, ka arritur që disa gjëra jo pa rëndësi t’i bëjë në mënyrë të pavarur. Për këtë, z. Nikoliqi thotë se kur është fjala tek nënat, rëndësi të veçantë në punën e tyre në Qendër i kanë kushtuar punës me fëmijë dhe këtu nënat në një farë forme edukohen se si të punojnë me fëmijët si dhe edukimin e vetëdijësimin në mjedisin ku jetojnë. Kjo Qendër, padyshim se me punën dhe angazhimin e saj ka bërë që të jetë një portë drejt afrimit kulturor mes popujve në shoqërinë zvicerane, dhe me të drejtë shpeshherë nga



Kabineti për energji solare



Kursi i informatikës, Basel



Kursi administrativ, Gjakovë

Nuk është i paktë numri i të interesuarve që duan të vijnë kurset e kësaj Qendre, qoftë në Kosovë, qoftë në Zvicër. Për këtë mund të orientohen në këto adresa: Ausbildungsund Beratungsstelle für,

Migrantinnen und Migranten ABSM), Gempenstrasse 27, 4053 Basel, dhe në tel: +41 61 361 85 88, e-mail: info@absm.ch, www.absm.ch. Kurse në Kosovë: ABS – Këshillimorja, Bankoos 11, Gjakovë – Kosovë, +381 390 24 562, absksh@hotmail.com

ndryshëm zviceran dhe shqiptarë, kryesisht nga profesionistët. Vështirësitë e fillimit sa i përket financimit të projekteve që kanë pasur të bëjnë me Qendrën, pas dy vitësh punë intensive dhe kryesisht vullnetare gjatë së cilës bënë që të dëshmohet seriozitet dhe besueshmeri. Me këtë rast, Skender Nikoliqi dhe stafi i tij i Qendrës për Arsimim dhe Këshillim, falenderon përzemërsisht të gjithë ata që kanë ndihmuar, si nga komuniteti shqiptar poashtu edhe të shoqërisë vendore zvicerane. /N.B./